

Perspektivat teorike [teoriticientët] ¹³	
Maslow (Perspektiva Humaniste)	Parten (Fazat e Lojës/ Aspektet sociale të Lojës)
<ul style="list-style-type: none"> • Nevojat bazike të fëmijëve duhet të jenë të përmbushura dhe fëmijët duhet të ndjehen të sigurtë në aspektin psikologjik, në mënyrë që të mësuarit të ndodhë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Aftësia dhe dëshira për tu bërë pjesë e grupeve të fëmijëve fillon në fazat e para të zhvillimit të fëmijëve dhe zhvillohet krahas zhvillimit të tyre. ▪ Loja realizohet në forma të ndryshme, varësisht nga grup moshë e fëmijëve.
Implikimet praktike	Implikimet praktike
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përgjatë punës me fëmijë, zhvillimi social dhe emocional duhet të jetë pjesë thelbësore e programeve të edukimit, dhe se institucioni duhet të sigurojë mundësi që fëmijët të krijojnë ndjenjën e arritjes, duke ofruar një ambient tërheqës dhe të këndshëm për edukim. 	<ul style="list-style-type: none"> • Edukatorët duhet të kuptojnë se fazat e zhvillimit të lojës nuk mund të jenë gjithmonë të njëjta në të gjitha grupet e fëmijëve; • Fëmijë të caktuar nuk mund të përparojnë drejtpërdrejtë nga një fazë në fazën tjetër të lojës; • Edukatorët duhet të kuptojnë se niveli i angazhimit të fëmijëve në faza të ndryshme të lojës, varion dhe ndikohen nga faktorë të ndryshëm, përfshirë: temperamentin e fëmijës, ambientin, ose niveli se sa njëjshokët dhe shoqet e angazhuar në lojë.
<p>Shënime shtesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Studime të shumta të realizuara në fushën e edukimit dhe zhvillimit të fëmijëve, në mënyrë të vazhdueshme, gjithashtu potencojnë se në sistemet edukative për fëmijërinë e hershme, është me rëndësi që programet të bazohen edhe në <i>Brain Based Theories</i>: Caine & Caine, Jensen, Sylvester, dhe teoritë e motivimit të fëmijëve, shembull: Teorinë e Vetëvendosjes- Deci dhe Ryan (2008). 	

¹³ Fass, 2004, Härkönen 2011; Xu, 2010, Deci & Ryan, 2008, Whitebread, 2014).

KAPITULLI III

Veçoritë e kurrikulës bërthamë për grupmoshën e fëmijëve 0-5 vjeç

Strukturimi i grupeve edukative 0-5 vjeç

Kurrikula Bërthamë për grup-moshën e fëmijëve 0-5 vjeç përfshin nivelin 0-3 vjeç (çerdhe) dhe nivelin 3-5 vjeç¹⁴ (kopshtin). Ky dokument përmban në vete shkallën përgatitore të përcaktuar me dokumentin e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës.

Roli i institucioneve parashkollore në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve

Fëmijët në institucionet parashkollore, ndihmohen për zhvillim dhe krijimin e përvojës edukative për ambientim/përshtatje në një formë të sistemuar të të nxënies e cila organizohet nëpërmjet lojës.

Realizimi i procesit të zhvillimit dhe edukimit të kësaj grup-moshe organizohet përmes lojës, në mënyrë të integruar, e ndërlidhur me aktivitetet e përditshme të fëmijëve, duke i nxitur që të rrisin kureshtjen për vete, për familjen, shoqërinë, natyrën, dijen, kulturën dhe për teknologjitë e reja. Synim i punës edukative në këtë periudhë është edhe stimulimi/nxitja e kreativitetit dhe entuziazmit për qasje ndaj përvojave të reja dhe përballjes me situata reale jetësore.

Shkalla përgatitore - Edukimi në fëmijërinë e hershme

Kjo shkallë përfshin periudhën e fëmijës prej lindjes deri në 3 vjeç dhe grup-moshën prej 3 deri në 5 vjeç. Gjatë kësaj shkalle, fëmijët nëpërmjet lojës, përkrahen në zhvillimin e hershëm personal, përfshirë:

¹⁴ Ndarja e grupeve të fëmijëve është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr 19/2016 Për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë (për të dhëna të detajuara shih dokumentin)

- zhvillimin e aftësisë për të komunikuar në gjuhën amtare nëpërmjet aktiviteteve që ndihmojnë artikullimin e drejtë të fjalëve, pasurimin e fjalorit dhe ushtrimin e aftësisë për të dëgjuar të tjerët;
- zhvillimin e njohjes si: të menduarit, zgjidhja e problemeve, kuptimi i koncepteve, procesimi i informatës dhe inteligjencën e përgjithshme.
- zhvillimin fizik, ushtrimin e koordinimit të lëvizjeve trupore, zhvillimin e forcës, të ekuilibrit, muskujve, koordinimin sy-dorë dhe aftësimin për manipulim me objekte të ndryshme të përdorimit ditor;
- vetëdijesimin gradual për veten, për të tjerët dhe për mjedisin që e rrethon;
- zhvillimin e aftësive për të respektuar rregullat, për të dalluar të drejtën nga e gabuara dhe për të dalluar veprimet që lejohen prej atyre që janë të ndaluara;
- nxitjen dhe aftësimin për t'u angazhuar në mënyrë aktive në aktivitete praktike, për të vlerësuar rreziqet dhe për të respektuar rregullat elementare të higjienës dhe sigurisë. (MASHT, 2016)

Kompetencat kryesore për Edukimin në fëmijëri të hershme 0-5 vjeç

Kompetencat e parapara me kornizën kurrikulare rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe përcaktojnë rezultatet kryesore për zhvillim dhe edukim, të cilat duhet t'i arrijnë fëmijët në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme.

Këto kompetenca janë:

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (I)
2. Kompetenca e të menduarit (II)
3. Kompetenca e të mësuarit (III)
4. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (IV)
5. Kompetenca personale (V)
6. Kompetenca qytetare (VI) (MASHT, 2018)

Kompetencat reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënit, të cilat janë të përgjithshme e dhe shprehin atë se çfarë duhet të arrijnë fëmijët në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme deri në shkallën tjetër të edukimit.

<p><i>I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</i></p> <p><i>Komunikues efektiv</i></p>	<p>Me qëllim që fëmijët të përgatiten për t'u zhvilluar dhe edukuar si personalitete, të nxënë dhe të zhvillojnë aftësi komunikimi për t'u shprehur dhe për t'i kuptuar të tjerët. Për të zhvilluar shkathhtësitë e komunikimit, edukatorja nxit fëmijët që të shprehin mendimin, ndjenjat, emocionet dhe nevojat, lirshëm dhe në mënyrë të pavarur.</p>
<p><i>II Kompetenca e të menduarit</i></p> <p><i>Mendimtar kreativ, krijues dhe kritik</i></p>	<p>Edukatorët, përgjatë planifikimit të planit dhe programit si dhe realizimit të aktiviteteve me fëmijët, duhet të kenë për synim nxitjen e kureshtjes për të eksploruar, mendimin logjik dhe kritik, kreativitetin dhe vetëbesimin tek fëmijët.</p>
<p><i>III Kompetenca e të mësuarit</i></p> <p><i>Fëmijë i suksesshëm</i></p>	<p>Edukatorja nxit fëmijët për të eksploruar mjedisin që e rrethon duke i motivuar ata që të ndërveprojnë me to. Të orientojnë fëmijët drejt të nxënës përmes vëzhgimit dhe ndërveprimit të tyre me bashkëmoshatarët dhe ambientin që e rrethon.</p>
<p><i>IV Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis</i></p> <p><i>Kontribues produktiv</i></p>	<p>Edukatorja angazhohet që fëmijët të krijojnë dhe zhvillojnë idenë për ndërlidhjen e tyre me mjedisin duke i ndihmuar të kuptojnë rëndësinë e ruajtjes së ambientit që i rrethon. Të zhvillojnë konceptet për përgjegjësinë gjatë aktiviteteve edukative dhe duke kontribuar në krijimin e shprehive të mira.</p>
<p><i>V Kompetenca personale</i></p> <p><i>Individ i shëndetshëm</i></p>	<p>Për të zhvilluar kompetencën personale, edukatorja nxit fëmijët, që të kenë rol aktiv në aktivitete edukative të cilat i mundësojnë ndërveprimin me të tjerët përfshirë edhe familjen.</p>
<p><i>VI Kompetenca qytetare</i></p> <p><i>Qytetar i përgjegjshëm</i></p>	<p>Edukatorja motivon fëmijët që të ndërveprojnë mes vete duke iu ndihmuar atyre që të luajnë së bashku, ndihmojnë njëri tjetrin, shkëmbejnë gjëra të ndryshme gjatë aktiviteteve edukative dhe të kujdesen për gjërat që i rrethojnë.</p>

Tabela 3. Kompetencat kryesore për Edukimin në fëmijëri të hershme 0-5 vjeç

Rezultatet e të nxënit për kompetenca për EHF 0-5 vjeç

Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zbërthehen në rezultate të të nxënit për shkallë. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga të gjithë fëmijët me rastin e përfundimit të kësaj shkalle të kurrikulës. Rezultatet nuk mbulojnë të gjitha arritjet e zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve gjatë kësaj shkalle.

Ato shprehin kërkesat esenciale për arritjen dhe zhvillimin e kompetencave kryesore gjatë kësaj shkalle. Promovojnë integrimin e fushave kurrikulare, në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me kornizën e kurrikulës.

Rezultatet e të nxënit përkufizohen si: *“Deklarata që përshkruajnë atë se çfarë duhet të arrijë fëmija në fund të shkallës, të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë një fëmijë në fund të një shkalle apo niveli”*. Ato shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. (MASHT, 2016)

Rezultatet e të nxënit për kompetenca shprehin pritjet e edukatorëve, të autoriteteve arsimore, të prindërve dhe të shoqërisë në raport me arritjet konkrete, të matshme, të fëmijëve në fund të çdo shkalle të kurrikulës.

Ato duhet t’i paraprijnë hartimit të planeve dhe programeve, planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve edukative brenda dhe jashtë institucionit parashkollor dhe në përcaktimin e mjeteve dhe materialeve që vihen në shërbim të aktiviteteve. Për fëmijët të cilët nuk i arrijnë rezultatet e të nxënit për kompetenca në nivel shkalle kurrikulare, institucioni parashkollor në bashkëpunim me familjen duhet të organizojë aktivitete mbështetëse, plane individuale të punës [PIA] dhe forma të tjera të përkrahjes.

Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës përgatitore (krijimi themelor i koncepteve, qëndrimeve, vlerave), shkalla përgatitore - Edukimi në fëmijërinë e hershme

Në pjesën në vazhdim do të paraqiten rezultatet për kompetencë përmes së cilave edukatorët/ët orientohen në atë se çfarë duhet të presin nga fëmijët në periudha të caktuara (nga mosha 0 deri në 5 vjeç). Në shkallën përgatitore përfshihen moshat 0-5 vjeç,

megjithatë duke pasur parasysh se zhvillimi i fëmijëve gjatë kësaj periudhe është shumë i hovshëm, për edukatorët, prindërit dhe të gjithë personat që merren me fëmijët duhet të vlerësojnë të arriturat e fëmijëve para moshës 5 vjeçare që të sigurohen se zhvillimi dhe edukimi i fëmijëve është në rrugën e duhur. Prandaj ky dokument parasheh që rezultatet për kompetencë pavarësisht se do të vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, si tërësi ato duhet të maten në fund të moshës 3 vjeçare dhe moshës 5 vjeçare. Pra në kuadër të shkallës përgatitore është e nevojshme që të bëhet një vlerësim i të arriturave që fëmijët i kanë fituar nga lindja deri në moshën 3 vjeçare dhe vlerësimi tjetër i rezultateve për kompetencë të bëhet për të arriturat e fëmijëve të cilët i kanë fituar nga mosha 3 deri në 5 vjeç.

Kjo do të na jepte mundësinë që të vërejmë zhvillimin e vazhdueshëm tek fëmijët dhe në raste të caktuara edhe mund të bëjmë ndërhyrje të caktuara me qëllim të mbështetjes dhe avasimit të zhvillimit të tyre në situata të caktuara.

Rezultatet e prezantuara në tabelë paraqesin se çfarë duhet të arrijë fëmija i moshës së caktuar p.sh tek mosha 0-3 vjeç edukatorët duhet të planifikojnë dhe organizojnë aktivitete të cilat do të ndihmojnë fëmijët për të arritur këto rezultate deri në moshën 3 vjeçare (shih rezultatet e prezantuara në tabelat me nr. 4 dhe 5). Të njëjtin gjë duhet ta realizoj edhe për grup-moshat 3-5 vjeç, në të cilën edukatorët duhet të zhvillojnë aktivitete edukative të cilat do të ndihmojnë fëmijët për të arritur rezultatet e kompetencave, deri në fund të moshës 5 vjeçare.

Arritja e rezultateve të cilat janë të paraqitura në tabelë realizohet përmes lojës dhe aktiviteteve të tjera edukative. Gjatë planifikimit të aktiviteteve edukative edukatorët/ët duhet të formulojnë rezultate të të nxënit për aktivitete, të cilat duhet të jenë të qarta, konkrete dhe të matshme. Rezultatet e të nxënit për aktivitete duhet të kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e rezultateve për kompetence.

Integrimi ndërfaqshor- Çështje shumë e rëndësishme e planifikimit dhe organizimit të aktiviteteve është mënyra se si edukatorët e bëjnë integrimin e fushave. Edukatorët duhet të kenë parasysh që temat e ndryshme t'i organizojnë përmes lojës dhe aktiviteteve të ndryshme edukative. Secili aktivitet duhet të planifikohet mirë në mënyrë që fëmijët të kenë mundësi zhvillimi dhe edukimi në çdo fushë kurrikulare. Edukatorët/ët duhet të

fokusohen që planifikimet e tyre të përfshijnë secilën fushë kurrikulare duke bërë integrimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Fushat kurrikulare për këtë nivel nuk ndahen në lëndë por ato integrohen mes vete, në mënyrë që fëmijët të zhvillohen, edukohen, krijojnë eksperiencë përmes lojës.

Edukatoret/ët, rezultatet e të nxënësve për aktivitete duhet t'i mbështesin në foljet matëse sipas nivelit të Taksonomisë së Bloomit, duke filluar nga niveli njohës, niveli i të kuptuarit, niveli i zbatimit, niveli i analizës, niveli i vlerësimit dhe nivelin e krijimit.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencë duhet të kontribuojnë në zhvillimin dhe integrimin e arritjeve të fëmijëve në secilën fushë të kurrikulës, prandaj rezultatet e të nxënësve për aktivitete duhet të orientohen në të gjitha fushat zhvillimore (varësisht nga aktiviteti edukativ që do të organizohet për fëmijët).

Rezultatet e të nxënësve për kompetencë për shkallën përgatitore-mosha 0-3 vjeç					
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Komunikues efektiv-I	Kompetenca e të menduarit Mendimtar kreativ, krijues dhe kritik-II	Kompetenca e të mësuarit Fëmijë i suksesshëm-III	Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis Kontribuues produktiv-IV	Kompetencan personale Individi shëndetshëm-V	Kompetenca qytetare Qytetar i përgjegjshëm-VI
<p>Përdor fjalor më të zgjeruar gjatë komunikimit.</p> <p>Përdor fjali më të gjata dhe të formuluar më mirë.</p> <p>Fëmija komunikon me veten gjatë lojës. Kjo është dëshmi që fëmija e përdor</p>	<p>Janë të gatshëm të arsyetojnë dhe negociojnë në rrethana të ndryshme.</p> <p>Kanë durim të presin në plotësimin e nevojave të tyre.</p>	<p>Fillojnë të mësojnë sjelljen e duhur në përputhje me situatat.</p> <p>Përshtaten me sjelljen dhe disponimin e të rriturve.</p> <p>Dijne të sillen në përputhje me situatat të</p>	<p>Kanë të zhvilluar mendim të qartë për veten e tyre.</p> <p>Tregojnë aftësi për të qenë të pavarur.</p> <p>Nuk shqetësohen nga ndarja me prindërit/kujdestarët dhe personave të huaj.</p> <p>Shfaqin rezistencë ndaj kufizimeve që</p>	<p>Ndjehen të sigurtë edhe në vende të panjohura përderisa kanë afër njëri që i njohin.</p> <p>Shfaqin ndjenja (empati) për fëmijë më të vegjël se ta.</p> <p>Identifikojnë veten me</p>	<p>Shfaqin pavarësi personale dhe përpiqen të zgjidhin vet sfida.</p> <p>Sillen mirë nëse inkurajohen nga të rriturit.</p> <p>Shfaqin vlerat e tyre personale.</p> <p>Respektojnë të rriturit kur i</p>

<p>gjuhën për të menduar.</p> <p>Flet gjëra të njejta në mënyra të ndryshme, varësisht nga situata.</p> <p>Përdor gjuhën për të treguar se çfarë po ndodhë.</p> <p>Flet fjalë me kuptim të kundërt si: dje, nesër, poshtë-lartë etj por duke i ngatërruar.</p> <p>Përdor përemrat me saktësi.</p> <p>Përdor pyetje shpesh dhe me saktësi.</p>		<p>ndryshme psh kur duhet të jenë të qetë dhe kur mund të bëjnë zhurmë.</p> <p>Ndajnë gjërat dhe mund të presin radhën.</p> <p>Përdor lodrat për të shfaqur përvojat e veta.</p>	<p>u bëhen nga prindërit/kujdestarët</p> <p>Janë më pak rebelues dhe përdorin gjuhën në vend të sjelljes për të shprehur kërkesat e tyre.</p> <p>Ndryshojnë me lehtësi disponimin e tyre.</p> <p>Janë impulsiv dhe nuk tërhiqen lehtë nga kërkesat e tyre.</p> <p>Kërkojnë miratimin e të rriturve.</p>	<p>personazhet e filmave vizatimorë.</p> <p>Shfaq shenja të turpërimit, acarimit, dhe ndërgjegjësimit.</p> <p>Mund të përdorin toaletin gjatë ditës dhe natës.</p> <p>Lajnë duart por mund të ketë vështirësi t'i thaj.</p> <p>Vishen dhe zhvishen pa ndihmën e të rriturve.</p>	<p>caktojnë rregullat psh ku duhet të ulen, të shkojnë etj.</p> <p>Menaxhojnë sfida që ofrojnë mundësi për të shfaqur suksesin e tyre dhe të rrisin vetëbesimin e tyre.</p> <p>Zemërimi i tepërt mund të krijojë bindje negative për veten e tyre.</p>
---	--	--	---	--	--

Tabela 4. Rezultatet për kompetencë për shkallën përgatitore-mosha 0-3 vjeç

Rezultatet e të nxënit për kompetencë për shkallën përgatitore-mosha 3-5 vjeç					
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Komunikues efektiv-I	Kompetenca e të menduarit Mendimtar kreativ, krijues dhe kritik-II	Kompetenca e të mësuarit Fëmijë i suksesshëm-III	Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis Kontribuues produktiv-IV	Kompetenca personale Individ i shëndetshëm-V	Kompetenca qytetare Qytetar i përgjegjshëm-VI
Kanë një fjalor shumë më të zgjeruar dhe përdorin pa gabime.	Bënë pyetje për të nxjerrë informata .	Janë argumentues dhe reagojnë vullshëm me raste.	Kanë nivel të lartë të pavarësisë dhe vetëbesimit. Tregojnë nivel të zhvilluar të	Kënaqen me ndarje të shkurtëra nga prindërit dhe kujdestarët.	E kanë të zhvilluar idetë e individualitetit. Kur ndjehen të dashur dhe të

<p>Fjalori i fëmijës përfshijnë objekte, foma, madhësi të ndryshme nga jeta reale</p> <p>Përdor fjalor të cilat shprehin kundërshtitë e zakonshme.</p> <p>Fjalitë që i flasin kanë një strukturë të mirë edhe pse mund të ketë ndonjë gabim gramatikor.</p> <p>Shqiptimi i fjalëve mund të jetë akoma i nivelit fëmijëror.</p> <p>Përdor fjalë që lidhen me gjërat e dëgjua apo që ndërliken me lodrat e tyre.</p>	<p>Bënë pyetje më të qarta dhe logjike.</p> <p>Përdorin logjikën për të dhënë mendime për situata të caktuara.</p> <p>Janë të aftë të përfshihen në një lojë më të gjatë imagjinare.</p>	<p>Argumentojnë me prindërit/ kujdestarët në lidhje me kërkesat e tyre.</p> <p>Ka aftësi të bëjë një detyrë të caktuar nga fillimi deri në fund.</p> <p>I di funksionet e gjësendeve/objekteve të caktuara.</p>	<p>kontrollit mbi emocionet e tyre.</p> <p>Shfaqin dëshirën për të vepruar mirë dhe për të marrë miratimin e të rriturve.</p> <p>E kanë të zhvilluar ndjenjën e turpit nëse sjellja e tyre nuk është e pranueshme.</p> <p>Negociojnë me të rriturit për sjelljen dhe disiplinën e tyre.</p> <p>Janë të qëndrueshëm në kërkesat e tyre.</p> <p>Preferojnë lojëra garuese më shumë se lojëra ekipore.</p> <p>E shijojnë lojën në grup por me asistencë të të rriturve (në situata të caktuara).</p>	<p>Shfaqin kontroll të mirë mbi emocionet.</p> <p>Shfaqin rezistencë në raste të caktuara.</p> <p>Negociojnë dhe nuk heqin dorë lehtë kur kërkojnë diçka.</p> <p>Kërkojnë miratimin e të rriturve.</p> <p>Shfaqin ndjeshmëri ndaj nevojave të të tjerëve dhe dëshirën për të qenë të pranuar nga fëmijët e tjerë.</p> <p>Shfaqin shqetësime ndaj konflikteve por mund të qetësohen lehtë.</p> <p>Kanë të zhvilluar imazhin e qartë për veten e tyre dhe dallojnë veten nga të tjerët.</p>	<p>pranuar nga të tjerët nuk ndryshojnë konceptin për veten.</p> <p>Shfaq kujdes ndaj të tjerëve në situata të ndryshme.</p> <p>Merr përgjegjësi që i jep i rrituri dhe përpiket ta përfundojë me sukses.</p> <p>Percepton mjedisin përreth tij/saj</p> <p>Respekton rregullat e vendosura së bashku me të rriturit.</p>
--	--	---	---	---	--

Tabela 5. Rezultatet për kompetencë për shkallën përgatitore-mosha 3-5 vjeç

Loja dhe rëndësia e saj në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve

Shkencërisht është vërtetuar se loja është aktivitet primar nëpërmjet të cilës fëmijët arrijnë të zhvillohen, formojnë shkathtësitë, rrisin njohuritë për veten dhe mjedisin përreth. Loja është pjesë e rëndësishme e edukimit në fëmijërinë e hershme (Fleer, 2009), madje termi lojë kuptohet si sinonim i edukimit në fëmijërine hershme (Ailwood, 2003). Ndonëse gjatë zhvillimit të mendimit pedagogjik për lojën ka pasur mendime të ndryshme, e përbashkëta e këtyre mendimeve ishte, dhe është se loja është pjesë e pandashme e edukimit në fëmijërinë e hershme.

Të gjitha teoritë e përmendura në këtë dokument por edhe teoritë të tjera të cilat lidhen me zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve e fuqizojnë lojën si mënyrë më efektive përmes së cilës fëmijët zhvillohen dhe nxënë (Beckett, et al, 2018). Në publikimin e UNICEF me titull “Të mësuarit nëpërmjet lojës- Fuqizimi i të nxënësve nëpërmjet lojës në programet e edukimit të fëmijërisë së hershme” vihet në dukje rëndësia e lojës për edukimin në fëmijërinë e hershme (UNICEF, 2018). Sipas këtij publikimi *“Loja është mënyra më e rëndësishme përmes së cilës fëmijët përfitojnë njohuri dhe shkathtësi”*. (UNICEF 2018)

Loja është e rëndësishme për edukimin në fëmijërinë e hershme dhe përfshinë disa aspekte si: kuptimin më të mirë të gjërave, eksplorimin, ndërveprimin me mjetet dhe materialet e ndryshme dhe ndërveprimin me të tjerët, argëtimin, lëvizjen, angazhimin, përfshirjen, etj.

Përmes lojës fëmijët zhvillojnë bazën e njohurive dhe shkathtësive fundamentale për zhvillimin e tyre. Loja ju ndihmonë fëmijëve që të zhvillojnë imagjinatën, fantazinë por edhe rregullat, përgjegjësinë dhe udhëheqjen.

Sipas Mary D. Sheridan (2011): “gjatë lojës fëmijët mësojnë dhe zhvillohen si individë por edhe si anëtarë të komunitetit më të gjerë”.

Prandaj është shumë e rëndësishme që aktivitetet edukative të cilat duhet të planifikohen për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve të realizohen përmes lojës sepse në këtë mënyrë fëmijët zhvillohen dhe nxënë njohuri të reja në mënyrë të natyrshme. Zhvillohen dhe edukohen përmes argëtimit cila ndikon pozitivisht në aspekte të ndryshme e sidomos atij kognitiv, si dhe duke rrjedhur gjërat spontanisht. Megjithatë edukatorët për të planifikuar

dhe organizuar aktivitete edukative përmes lojës duhet të dijnë se pavarisht se aktivitetet shndërrohen në lojë ato gjithsesi duhet të jenë mirë të planifikuara dhe të bëhen me qëllim të caktuar, përmes së cilës fëmijët mund të zhvillohen në të gjitha aspektet, fizike, intelektuale, emocionale dhe sociale.

Çdo aktivitet i cili realizohet përmes lojës është lehtë i kuptueshëm për fëmijët dhe paraqet qëndrueshmëri në zhvillimin e tërësishëm të fëmijëve.

Edukatori/ja duhet të përgatis në mënyrë të vazhdueshme materiale didaktike që fëmijët të kenë mundësi të zhvillojnë lojëra në mënyrë individuale, dhe me grupe të vogla. Është shumë e rëndësishme që përgjatë qëndrimit të fëmijës në institucion parashkollor fëmija të ketë mundësi të zhvillojë lojëra/aktivitete me tërë grupin, lojëra/aktivitete me grupe të vogla në qendrat e aktiviteteve dhe lojëra/aktivitete në mënyrë individuale të cilat përmbushin nevojat e tij zhvillimore në varësi të fushës së interesimit.

Në varësi të qasjes metodologjike që edukatori/ja përdor organizon rutinën ditore në atë mënyrë që fëmijë të ballafaqohet me lojëra/aktivitete të cilat zhvillohen në mënyrë individuale, me grupe të vogla dhe me tërë grupin.

Për këtë arsye zhvillimi dhe edukimi i hershëm i fëmijëve bazën fundamentale e ka tek loja.

KAPITULLI IV

Qasjet metodologjike

Të kuptuarit e marrëdhënieve ndërmjet zhvillimit, procesit të nxënies dhe eksperiencës së fëmijës është thelbësore që të ofrohet një edukim cilësor për fëmijët në fëmijërinë e hershme (Jackman, 2012). Sot ekzistojnë qasje të ndryshme të cilat përdoren nëpër botë por mirë dihet se nuk ekziston një program universal i cili i përgjigjet karakteristikave dhe nevojave të secilit vend, prandaj secili vend për të ndërtuar një program cilësor duhet të bazohet në eksperiencën e tij të më parëshme dhe të mbështetet në praktikat e mira të vendeve të tjera (UNESCO, 2006).

Kurrikula bërthamë për edukimin në fëmijëri të hershme 0-5 vjeç ofron disa qasje metodologjike. Edukatorët janë të lira në përzgjedhjen e qasjeve metodologjike në nivel të institucionit duke përkrahur njëri/a-tjetrin/ën përmes zhvillimit profesional që mund t'u ofrohet qoftë brenda institucionit apo edhe më gjerë për të planifikuar dhe organizuar veprimtari edukative përmes qasjes metodologjike të caktuar. Përcaktimi i punës bazuar në një metodologji të caktuar, bëhet me qëllim të krijimit të mundësive për zhvillimin e potencialit të fëmijës bazuar në mundësitë e tij për lojë në ndërveprimin me fëmijët tjerë, të rriturit dhe mjedisin e institucionit parashkollor e më gjerë.

Në varësi të qasjes metodologjike e cila aplikohet në institucionin parashkollor në atë mënyrë reflekton edhe përgatitja e mjedisit për zhvillimin e gjithë veprimtarisë që zhvillohet në atë institucion. Prandaj secila qasje metodologjike e trajtuar në vazhdim ndjek një linjë zhvillimi duke filluar me idenë e përgjithshme, rolin e edukatorit/es, rregullimin e mjedisit përfshirë qendrat e aktiviteve, përfshirja e familjes dhe burimet shtesë¹⁵.

¹⁵Bashkëpunimi me familjen trajtohet si pjesë e qasjes metodologjike, ndërsa mbi mënyrat e realizimit të bashkëpunimit me familjen dhe komunitetin shih kapitullin VI

Puna me fëmijët sipas metodologjisë së Montesorit

Metodologjia montesoriane u zhvillua nga Maria Montesori, e cila besonte fuqishëm në personalitetin unik të çdo fëmije. Ajo poashtu besonte që fëmijët më së miri mësojnë përmes eksperiencave shqisore (Mooney, 2013) prandaj i kushtoj një rendësi të madhe zhvillimit të tyre. Aftësia e fëmijës që të vëzhgojë, hulumtojë, eksplorojë, bëjë pyetje, ndajë idetë e tij me të tjerët është mënyra përmes së cilës fëmijët rriten dhe zhvillohen. Prandaj nxitja e kureshtjes së fëmijëve për të ekspozuar dhe observuar i bënë ata të jenë të përfshirë në procesin e të nxënës (Isaacs, 2010) dhe të drejtojnë të nxënës e tyre përmes mbështetjes së edukatoreve dhe krijimit të mjedisit bazuar në nevojat që ata kanë.

Roli i edukatorit/es sipas metodologjisë së Montesorit

Edukatori/ja në metodologjinë montesoriane ka një rol shumë dimensionale dhe të patjetërsueshëm, ai/ajo i ngjanë një organizuesi që me mjeshtri përgatit mjedisin e të nxënës për zhvillimin e aktiviteteve, planifikimin dhe realizimin e tyre. Ai/ajo observon dhe mban shënime në mënyrë të vazhdueshme mbi zhvillimin e fëmijëve, ndërveprimin e fëmijës me mjedisin, lodrat, mjetet dhe materialet, ndërveprimin e fëmijës me bashkëmoshatarët dhe të rriturit, observon dhe mban shënime për fushat e tij të interesit në mënyrë që të jetë në gjendje të përgjigjet nevojave individuale të secilit fëmijë. Rutina ditore është planifikuar në mënyrë të tillë që fëmijët të mund të zhvillojnë lojëra-aktivitete në formë të pavarur, aktivitete me tërë grupin dhe aktivitete me grupe të vogla. Aktivitete ditore zhvillohen në formë të integruar, në koherencë dhe kohezion. Edukatori/ja përkrah fëmijën në vetë iniciativën e tij për lojë dhe krijimtari.

Në metodologjinë montesoriane fëmija është në qendër të aktiviteteve prandaj edukatori/ja planifikon dhe realizon aktivitetet duke përbushur nevojat dhe interesat e fëmijës.

Edukatori/ja në mungesë të materialeve apo lodrave sipas metodologjisë montesoriane mund të konstruktojë materiale- lodra të ngjashme¹⁶ me të cilat fëmijët mund të luajnë dhe ndërveprojnë. Një kujdes të tejshtuar gjatë konstrukimit të materialeve - lodrave edukatore

¹⁶ Sidoqoftë është me rëndësi që përgjatë konstrukimit të materialeve dhe ose lodrave të veçanta për fëmijët, materialet e përdorura të jenë të përshtatshme, dhe pa ndonjë materie me rrezik për shëndetin e fëmijëve.

duhet ti kushtojnë cilësisë së materialeve, në mënyrë që të jenë të përshtatshme për zhvillimin moshor të fëmijës dhe që nuk përbëjnë rrezik për shëndetin e fëmijës¹⁷.

Edukatori/ja duhet të krijojë një klimë të mirë sociale dhe mjedis i cili i përgjigjet nevojave zhvillimore të fëmijës. Observimi dhe mbajtja e shënimeve në mënyrë të vazhdueshme ndihmon edukatoren në planifikimin bazuar në nevojat e fëmijës dhe rezultateve të të nxënit, po ashtu lejon që edukatori/ja të reflektojë mbi rezultatet e arritura dhe hapat e ardhshëm.

Eduktorët i ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë shkathtësitë e tyre duke i lejuar dhe inkurajuar fëmijët të ndër marrin përgjegjësi dhe zhvillojnë veprimtari të cilat i ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë kompetencat bazuar në mundësitë që ata kanë. Një edukatore e cila punon sipas

metodologjisë montesoriane ndihmon fëmijët në krijimin e shkathtësive të pavarura për lojë. Sipas Mooney (2013) Montesori pohon se fëmijët fitojnë më shumë kompetencë kur ata përfshihen në aktivitete të cilat janë të ngjashme me jetën reale, këto ndihmojnë në ngritjen e vetëvlerësimit të fëmijës.

Roli i edukatores në përdorimin e lodrave-
materialeve sipas metodologjisë Montesoriane?

- Fillimisht lodrat gjinden në një raft të hapur, ku mund të arrihen nga fëmija.
- Secila prej tyre ka vendin e caktuar.
- Edukatori/ja kalon kohë individuale me secilin fëmijë duke i demonstruar mënyrën sesi funksionon një lodër e caktuar.
- Ai/ajo i demonstroi fëmijës si ta trajtojë lodrën me kujdes dhe ndjeshmëri.
- Edukatori/ja i demonstroi fëmijës se si të vendosë fillimisht një material bazë mbi të cilin pastaj vendosen pjesëzat e lodrës dhe fëmija zhvillon lojën.
- Pasi fëmija të përfundojë lojën ai/ajo duhet që ta kthejë përsëri lodrën në vendin përkatës, në mënyrë të rregullt,
- Ky proces siguron që lodra të jetë e gatshme të përdoret nga ndonjë fëmijë tjetër.
- Materialet në të cilin është vendosur lodra mbështillet dhe vendoset në vendin e caktuar.

Mos harroni!

Çdo gjë e mirë kërkon kohë, nëse gradualisht ndërtojmë një rregull të tillë, atëherë do të mund t'ia dalim ...

¹⁷ Një kujdes i tillë duhet të jetë i përhershëm pavarësisht metodologjisë së punës që edukatori/ja përdorë

Rregullimi i mjedisit sipas metodologjisë së Montesorit

Përgatitja e mjedisit me materialet didaktike sipas konceptit të Montesorit mbështet zhvillimin e fëmijë në pikëpamje holistike, duke respektuar ritmin e tyre individual të zhvillimit dhe ofrimit të mbështetjes në bazë të nevojave që ka secili fëmijë.

Mjeti më i mirë përmes së cilit fëmijët zhvillojnë të nxënit është loja, e cila ndihmon dhe nxit fëmijët që në mënyrë spontane të zhvillojnë të nxënit.

Mjedisi fillimisht duhet të ketë dritë të mjaftueshme, të sigurojë ajrosje dhe të ketë hapësirë të bollshme për zhvillimin e aktiviteteve në hapësirat e brendshme dhe ato të jashtme të institucionit. Hapësira duhet të jetë e mjaftueshme që fëmijët të mund të lëvizin lirshëm nga një qendër e aktivitetit në qendrën tjetër, ndërsa dritaret duhet të jenë të një niveli të atillë që lejojnë që fëmijët të mund të shohin jashtë. Hapësira duhet të jetë e ngjyrosur me ngjyra të hapura të cilat janë në harmoni me mobilet tjera në dhomë, e poashtu të sigurojnë një harmoni dhe atmosferë ftuese (Feez, 2010)

Në grupet edukative nga mosha 6/9 muaj – 3 vjeç procesi i të nxënit planifikohet mbi baza individuale përgjatë rutinës ditore duke respektuar ritmin natyror të zhvillimit të fëmijës, i cili ritëm ndikon në krijimin e rutinës ditore sikurse koha e lojës, koha e veprimtarive të qeta, koha e gjumit, koha e ushqimit dhe loja në natyrë përgjatë ditës (Isaacs, 2010).

Lojërat- aktivitetet që stimulojnë zhvillimin e shkathtësive fizike, lojërat-aktivitetet nga jeta e përditshme– si ushqyeshmëria, higjiena, vetëkujdesi. Aktivitetet që stimulojnë zhvillimin e shqisave dhe aktivitetet që stimulojnë zhvillimin e të folurit zhvillohen përgjatë rutinave ditore në mënyrë spontane në hapësirën brenda dhe jashtë dhomës. Të gjitha lojërat-aktivitetet e zhvilluara i sigurojnë fëmijës një mundësi të mirë për zhvillimin e gjithanshëm të tij. Lodrat manipulative,

*Si ta përshtatim mjedisin me nevojat e fëmijës?
psh. nëse një fëmijë është duke fituar pavarësinë në të ecur ne duhet ta lejojmë ta praktikojë atë e jo ta drejtojmë drejt të ecurit këmba-dorës vetëm pse do na duket më e sigurt. Përkundrazi, edukatori/ja duhet të zhvillojë aktivitete me këtë fëmijë që i mundësojnë lëvizjen dhe zhvillimin e balancit në të ecur përmes mjeteve ndihmëse si shkallët e vogla të drurit me parmak në te dyja anët.*

lodrat sajuese, këngët, këngët ritmike dhe leximi i librave janë poashtu pjesë e rutinave ditore në metodologjinë montesoriane.

Klasifikimi i lodrave– materialeve në shporta përkatëse, vendosja e tyre në rafte të arritshme nga fëmijët dhe organizimi i tyre në mënyrë që të jenë të qasshme dhe të shfrytëzueshme nga fëmijët krijon tek fëmijët ndjenjën e përkatësisë në grup dhe rrit mundësinë për aktivitete të pavarura.

Në grupet edukative nga mosha 3 – 5 vjeç mjedisi është i ndarë në qendra të aktiviteteve të cilat janë të ndërlidhura njëra me tjetrën dhe ndërtojnë një mjedis ku gjithçka është në harmoni, vendosja e lodrave- materialeve në lartësi të arritshme nga fëmijët, hapësirat e lira për zhvillimin e lojës, tavolinat e përshtatshme për grup-moshën duke mundësuar kështu që mjedisi ti përshtatet nevojave të fëmijës për lëvizje dhe zhvillim të lojës-aktiviteti në formë sa më të natyrshme. Lodrat-materialet janë të modeluara në forma, madhësi, ngjyra dhe materiale të ndryshme në atë formë që të fëmijët të krijojnë eksperiencë të reja përgjatë ndërveprimit me to. Sipas metodologjisë montesoriane mjedisi i të nxëniet ndahet në:

Qendra e aktiviteteve praktike- në këtë qendër fëmijët kanë mundësi të praktikojnë shkathtësitë që i duhen atij në jetën e përditshme në kopsht dhe shtëpi poashtu. Përmes lojës-aktiviteteve në këtë qendër fëmija zhvillon kompetencat që atij i duhen për jetë të pavarur. Fëmijëve tek kjo qendër ju ofrohet mundësia të zhvillojnë aktivitete e jetës së përditshme të cilat janë familjare për ta sikurse servimi i ushqimit, mbushja dhe zbrazja e lëngjeve, pastrimi, mirëmbajtja e hapësirës, veshja, kujdesi për mjedisin, ujitja e bimëve etj (Isaacs, 2010).

Qendra e zhvillimit të shqisave- në këtë qendër përmes materialeve të përgatitura sipas konceptit montesorian fëmijët nxisin zhvillimin e tyre shqisor. Sipas Montesorit zhvillimi i shqisave është bazë për zhvillimin e zgjerimin e kapaciteti intelektual të fëmijës (Isaacs, 2010), andaj përmes lodrave-materialeve për zhvillimin shqisor edukatorët orientojnë dhe udhëzojnë fëmijët drejt përdorimit të tyre. Përmes krahasimit të formave dy dimensionale dhe tri dimensionale, përmes lodrave-materialeve që nxisin nuhatjen; përmes lodrave-materialeve që nxisin dëgjim, të dëgjuarit e tingullit dhe klasifikimin e tij; përmes lodrave-

materialeve që nxisin të prekurit si formë bazë të njohjes fëmijët kanë mundësi të zgjerojnë perceptimin e tyre për materialet përreth ose ti shohin ato nga një perspektiv tjetër. P.sh. nga kutia e thesarit të gjejnë dy objekte të njëjta vetëm përmes prekjes, një aktivitet si ky ndihmon fëmijët në aftësitë perceptive, klasifikimin dhe grupimin sipas vetive.

Qendra e gjuhës dhe komunikimit- fëmijët në institucionet parashkollore të cilat punojnë me metodologjinë montesoriane i ekspozohen në mënyrë të vazhdueshme komunikimit, dëgjimit, leximit të historive, përdorimit të fjalëve të reja- zgjerimit të fjalorit, ndërveprimit me libra, fotografi, objekte dhe në këtë mënyrë gradualisht përgatiten për procesin e njohjes së tingujve, tingullit dhe grafikut përmes shkronjave me relief të ngritur (Isaacs, 2010). Fëmijët janë në ndërveprim të vazhdueshëm me materiale që nxisin të shprehurit, njohjen e emërtimeve të gjërave përreth dhe gjithë ky proces zhvillohet duke pasur parasysh aktivizimin e sa më shumë shqisave. Secili fëmijë fillon njohjen e tingujve, shkronjave, fjalëve atëherë kur ai është i gatshëm dhe shpreh interesim për këtë. Edukatorët duhet të përdorin një varg lodrash-materialesh për ta nxitur zhvillimin gjuhësor të fëmijës nëpërmjet lojës. P.sh. shoqërimi i kafshëve ose objekteve me shkronjën që fillon, modelimi i shkronjës në kutin me rërë etj.

Qendra e numrave dhe numërimit- përmes aktiviteteve të zhvilluara në qendrën e zhvillimit shqisor të cilat kanë të bëjnë me format, ndarjen, klasifikimi, grupimi përgatiten për aktivitete më komplekse matematikore të cilët shumë natyrshëm përmes lodrave-materialeve montesoriane kuptohen nga fëmijët. Për zhvillimin e numrit dhe veprimeve të thjeshta aritmetikore në metodologjinë monteroriane përdoren lodra-materiale të cilat i mundësojnë fëmijës që praktikisht dhe në mënyrë të natyrshme të kuptojë fillimisht konceptin mbi numërimin dhe pastaj edhe grafikun e numrit dhe lidhjen në mes tyre. Përmes përdorimit të materialit didaktik “Sferave të arta” fëmijët zhvillojnë fillimisht konceptin mbi numërimin pastaj përmes kartonëve me simbolet e numrit gradualisht bëhet ndërlidhja në mes të sasisë së numrit me grafikun e tij. Të gjithë këtij procesi i paraprijnë edhe një varg aktiviteteve tjera përmes lodrave-materialeve të tjera të cilat poashtu kanë për qëllim të forcojnë aspekte të veçantë matematikore. Tek metodologjia montesoriane numrat dhe numërimi nuk janë të kufizuar vetëm në qendrën e matematikës, ata i gjejnë të pranishëm në të gjitha aktivitetet që fëmijët mund të zhvillojnë në kontekstin e jetës së

përditshme si ndarja e biskotave për secilin fëmijë nga një, shfletimi-leximi i librave që kanë në përbërjen e tyre të dhëna që ndërlidhen me konceptet matematikore, orientimin hapësinor, lojëra të ndryshme grupore, aktivitetet në natyrë, kopshtaria, matjet etj.

Qendra e kreativitetit- mundëson që fëmijët të shprehin kreativitetin e tyre përmes përdorimit të formave të ndryshme të shprehjes artistike si vizatimi, muzika, vallëzimi, lojërat socio-dramatike aktivite këto të cilat ndihmojnë fëmijët të shpreh vetveten dhe zhvillojë vetiniciativën (Isaacs, 2010). Materialet të cilat gjinden në këtë qendër janë të llojllojshme duke filluar nga letra të madhësive dhe kualiteteve të ndryshme, ngjyra të ndryshme si: druri, uji, dylli etj. Poashtu në hapësirën e kësaj qendre ndodhen edhe një varg materiale të tjera të cilët i mundësojnë fëmijët të zhvillojë kolazhe të ndryshme dhe shpreh aftësitë e tij kreative përmes përdorimit të mjeteve për stampim, prerje-ngjitje etj. Lojërat dramatike nuk zhvillohen në mënyrë të organizuar atë vijnë spontanisht dhe zhvillohen nga vetë fëmijët bazuar në tregimin e lexuar apo situatën e krijuar, spontaniteti dhe liria e zhvillimit të lojës ndihmon fëmijët në zhvillimin e vetiniciativës dhe shprehjen e kreativitetit.

Qendra e kulturës dhe shkencës- ofron një mundësi për fëmijët dhe edukatorët të eksplorojnë përmes eksperiencave të drejtpërdrejta një varg temash të cilat janë të ndërlidhura njëra me tjetrën. Lodrat-materialet e ofruara i takojnë fushës së biologjisë, gjeografisë, historisë dhe zgjojnë interesimin e fëmijët për të observuar, eksploruar mbi pemët, stinët, fermën, kafshët, sistemin diellor, vullkanet, njerëzit, lëvizjen, veshjet, transportin e shumë fusha të tjera. E veçanta në këtë qendër qëndron se në varësi të interesimit të fëmijës rreth një lodre-materiali didaktik, edukatori/ja e ndihmon atë të zgjerojë njohurit, ballafaqimin me fjalë të reja, shpjegimin e procesit, ofrimin e materialeve ndihmëse si leximi i librave etj. Kjo mundëson që gjatë punës në këtë qendër edukatori/ja të mos imponojë perspektivën e tij/saj mbi atë se çfarë fëmijët duhet të mësojnë por të planifikojë dhe ndërtojë aktivitetet në varësi të interesimit të fëmijës.

Hapësira e jashtme- është në funksion të zhvillimit të fëmijës dhe përdoret në forma të ndryshme, hapësira e jashtme i'u mundëson fëmijëve të zhvillojnë aftësitë e tyre në eksplorimin dhe vëzhgimin e botës së gjallë dhe asaj jo të gjallë. I ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësitë e tyre përceptive dhe zhvillimin e shqisave. I ndihmon poashtu në

praktikimin dhe zhvillimin e aftësive fizike dhe njohjen me sportin etj. Edukatorët duhet që me mjeshtri të përdorin mjedisin e jashtëm dhe ta vendosin atë në shërbim të zhvillimit të gjithmbarshëm dhe mirërritjes së fëmijës. Fëmijët duhet të jenë në kontakt me natyrën, me lojën, lojërat dhe aktivitetet e organizuar në natyrë në baza ditore, përveç rasteve kur një gjë e tillë përshkak të kushteve klimatike nuk mund të realizohet.

Bashkëpunimi me familjen është pjesë përbërëse e qasjes montesori duke siguruar në këtë mënyrë në jetëgjatësi të veprimtarisë që fëmija bënë në institucione. Ndërveprimi i mirë në mes të dy palëve siguron që fëmija të rritet në një mjedis të shëndetshëm duke zhvilluar individualitetin e tij, shkathësitë e tij për jetë dhe punë të pavarur në harmoni me mjedisin ku jeton.

Ju mund të kërkoni për më shumë të dhëna në burimet elektronike si:
<https://montessoriguide.org/authors-page>
<https://montessori-n.org>
<https://montessori-ami.org>
<https://montessori-europe.net/>

Puna me fëmijët sipas metodologjisë Rexhio Emilia

Metodologjia Rexhio Emilia u zhvillua nga Loris Malaguzi në krahinën Rexhio Emilia inspiruar nga puna e Maria Montesorit dhe Jean Piazhes poashtu. Idet e Loris Malaguzit mbi kreativitetin dhe mendimi që secili fëmijë për nga natyra është kreativ por që duhet të krijohen mundësitë për zhvillimin dhe shfaqjen e aftësive kreative kanë rezultuar në konceptimin e kësaj metodologjie (Thornton & Brunton, 2010).

Metodologjia Rexhio Emilia integron gjashtë komponentet përbërëse duke filluar nga: të pasurit e një vizioni të përbashkët për fëmijën, puna së bashku dhe vlerësimi i raporteve, dëgjimi aktiv, konsultimi me fëmijët, përfshirja e familjes dhe lidhja me komunitetin (Thornton & Brunton, 2010).

Sipas metodologjisë Rexhio Emilia fëmija është i vetëpjesëmarrës në përcaktimin e asaj që ai /ajo dëshiron të eksplorojë, përmes diskutimeve me edukatorët/fëmijët përmes pyetjeve të tyre inicohet edhe zhvillimi i veprimtarisë që e cila kryesisht organizohet në formë të projekteve tematike, projekteve mjedisore, projekteve të jetës së përditshme, projekteve që

vetë-menaxhohen nga fëmijët (Thornton & Brunton, 2010) nën nxitjen dhe observimin e vazhdueshëm të edukatorit/es.

Roli i edukatorit/es sipas metodologjisë Rexhio Emilia-

Edukatori/ja pa diskutim që në metodologjinë Rexhio Emilia ka një rol tejet të madh në krijimin e një mjedisi ku fëmija është aktiv, i përfshirë dhe është në qendër të veprimtarisë që zhvillohet në institucionin parashkollor. Ajo që e bënë të veçantë një edukator/e rexhiane është fakti se fëmijët nuk e shohin atë si gjykuese ose vlerësuese të punës së tyre por si një person i cili është gjithmonë i gatshëm t'i ndihmojë, mbështes dhe nxisë ata drejt kapërcimit të një sfide apo ndërmarrjes së ndonjë veprimi të ri (Mato & Kamani, 2000). Rutina ditore është e organizuar në mënyrë të tillë që lejon fleksibilitet të veprimeve në varësi të nevojave të fëmijës. Puna edukative organizohet bazuar në punën me projekte. Projektet për të cilat punohet vijën si rezultat i pyetjeve dhe interesimit të fëmijëve rreth një çështje të caktuar. Tema e projekteve mund të jenë nga më të ndryshmet në varësi të situatave dhe çështjeve të diskutuara, prandaj roli i edukatores në formësimin dhe zhvillimin e projekteve të fëmijëve është mjaft i rëndësishëm. Edukatori/ja luan rolin e lehtësuesit por jo në ofrimin e zgjidhjeve të gatshme por në rolin e lehtësuesit në ndërtimin e njohurive sepse janë gjithmonë fëmijët atë që me punën dhe pyetjet e papritura i japin jetë zhvillimit të projektit dhe sigurojnë vazhdimësinë e tij. Gjatë ditës fëmija i ekspozohet eksperiencave në punë të pavarur në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm, kjo veprimtari mund të zhvillohet në mënyrë individuale ose në grup të vogël. Gjatë një dite fëmija përfshihet në aktivitete me tërë grupin, në aktivitete me grupe të vogla por edhe në formë individuale, alternimi i veprimtarive zhvillohet në varësi të projektit dhe fushës së interesimit të fëmijës.

Observimi i vazhdueshëm dhe dokumentimi i punës së fëmijëve dhe veprimtarisë që fëmijët zhvillojnë është një karakteristikë tjetër identifikuese e kësaj metodologjie. Edukatori/ja i/e cila punon me metodologjinë Rexhio Emilia duhet të zhvillojë aftësitë e tij/saj vëzhguese meqë vëzhgimi dhe dokumentimi i vazhdueshëm i punës së fëmijëve na ndihmon që t'i përgjigjemi nevojave të fëmijëve dhe të kuptojmë nivelin e tyre zhvillimor.

Një rol të rëndësishëm krahas edukatorit/es ka edhe atelieri/ja e cila është burim mbështetje dhe frymëzimi për të provuar forma të reja të shfaqjes artistike dhe ndihmuar e udhëzuar fëmijët në manifestimin e anës së tyre artistike. Secili projekt në fund kurorëzohet me një manifestim të përbashkët në institucion parashkollor përfshirë fëmijët, edukatorët, prindërit e komunitetin. Prandaj zhvillimi i shpirtit artistik dhe dokumentimi i realizimit të veprimtarisë dhe procesit nëpër të cilin ka kaluar fëmija gjatë periudhës kohore të realizimit të projektit brenda metodologjisë rexhiane është tepër i rëndësishëm. Puna e përbashkët me edukatorët e tjera brenda grupit por edhe brenda institucionit si dhe bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin krijon mundësi për një ndërlidhje të veprimtarisë/projekteve që zhvillohen në institucion me aktivitetin e fëmijës jashtë tij. Procesi i observimit dhe dokumentimit, si dhe organizimi i projekteve edukative në bashkëpunim me familjen dhe pjesëmarrjen aktive të saj në të gjitha proceset që organizohen në institucion parashkollor janë tipare identifikuese të kësaj metodologjie.

Rregullimi i mjedisit sipas metodologjisë Rexhio Emilia

Rregullimit të mjedisit në institucionet të cilat punojnë me metodologjinë Rexhio Emilia i kushtohet një kujdes tepër i madh. Është i njohur edhe postulati “mjedisi është edukatori i tretë i fëmijës”, kjo tregon që poashtu edhe mjedisi është në funksion të realizimit të komponentës edukative dhe asaj zhvillimore.

Mjedisi përgjithësisht është i strukturuar në formë të tillë që të krijojë hapësirë për lëvizjen dhe manipulimin e lirë të fëmijës me lodrat, mjetet dhe materialet që ai përdorë. Hapësira brenda dhe ajo jashtë korrespondojnë njëra me tjetër dhe ndodh që gjatë zhvillimit të ndonjë veprimtarie të përdoren nga fëmijët dy hapësirat paralelisht. Ekziston një hapësirë në të cilën organizohen takimet e përbashkëta që në metodologjinë rexhiane njihet me emrin asambleja e përbashkët.

Pastaj janë hapësirat e organizuara për zhvillimin e veprimtarive në formë të pavarur ose në grupe të vogla ku lodrat dhe materialet janë të ekspozuara në varësi të fushëveprimit. Ekziston edhe një hapësirë e përbashkët e ndarë nga dhoma e punës që quhet atelie, vend

ky ku fëmijët nën ndikimin e atelierit/es zhvillojnë dhe zgjerojnë krijimtarinë e tyre lidhur me projektin.

Rregullimi i mjedisit për fëmijët deri në moshën 3 vjeçare kryesisht është i organizuar në një hapërsirë që i përgjigjet nevojave zhvillimore të fëmijës, lodrat janë të vendosura në raftet e hapura të cilat janë të arritshme nga fëmijët. Organizimi i mjedisit duhet të mbështes dhe promovojë të nxënien aktiv të fëmijës, hapësira duhet të jetë komode, mirë e organizuar dhe ti mundësojë fëmijës ndërveprim të lehtë me të tjerët, ndërveprim me lodrat dhe materialet që gjenden në dhomë.

Mjedisi duhet të reflektojë harmoni dhe pozitivitet, lodrat dhe materialet janë kryesisht i përngjajnë objekteve të jetës së përditëshme ato mund të jenë të fabrikuara por dhe të përbëra nga materialet natyrore. Lodrat dhe materialet kryesisht janë të vendosura në shporta në përputhje me moshën e fëmijës.

Lodrat dhe materialet herë pas here ndërrohen në varësi të fokusit të punës me fëmijët. Ndër objektet e jetës së përditëshme që mund të përdoren janë paisje të ndryshme për kuzhinë sikurse enë të ndryshme nga druri dhe metali, lugë druri të madhësive të ndryshme, (rrolling pin), paisje të ndryshme higjienike dhe të fabrikuara, materiale natyrore sikurse guackat, boqa pishe, rërë, guralec etj. në përdorimin e materialeve natyrore jo të fabrikuara por edhe në paisjet tjera gjithmonë duhet të kemi kujdes të tejshtuar në raport me përdorshmërinë e tyre nga ana e fëmijëve.

Edukatori/ja ka përqëllim që përmes rregullimi të mjedisit ti sigurojë fëmijës një gamë të gjërë lojrash-aktivitetesh që ai mund të zhvillojë në përputhje me zhvillimin e tij moshor, nevojat dhe interesat e tij. Ndër aktivitete që fëmija mund të zhvillojë janë loja me lodra të buta, përzierja e ngjyrave, loja në tavolinën me dritë, lojëra të qeta pranë pasqyrës, bërja e gjurmëve, lojëra me ujë dhe rërë, mbushje dhe zbrastje e enëve me oriz, miell gruri etj, dëgjimi i historive, shfletimi i librave,

Në institucionet të cilat punojnë sipas programit të Rexhio Emilia gjindet tavolina me dritë. Kjo tavolinë brenda ka një llamp ndriqese e cila mundëson që fëmijët të fitojnë një këndvështrim tjetër për gjërat. Mbi atë tavolinë mund të vizatohet, ngjyroset, luhet me guralec, eksperimentohet me hijet e objekteve etj. Edukatori/ja këtu luan një rol nxitës ku përmes pyetjeve mund të krijojë situata të reja, prova të reja të cilat fëmija dëshiron t'i eksporojë.

eksplorimi i materialeve në natyrë etj. Në të gjitha veprimtaritë ku fëmija merr pjesë edukatori/ja me kujdes observon dhe dokumenton pjesëmarrjen e tij në mënyrë që të përciellë dhe planifikojë edhe veprimtaritë por edhe mjedisin në përputhje me nevojat dhe interesat e fëmijës.

Rregullimi i mjedisit për fëmijët nga mosha 3-6 vjeç ka një varg veçorish përfshirë edhe mundësinë për të ndryshuar në përputhje me nevojat dhe interesat e fëmijës. Hapësira zakonisht krijohet në fillim të vitit dhe mund të ndryshojë në varësi të projekteve në të cilat janë duke punuar fëmijët. Kryesisht mjedisi është i organizuar nëpër qendra të aktiviteteve të cilat kanë një lidhshmëri njëra me tjetrën për nga organizimi. Në funksion të projekteve mund të ngrisin qendra të reja ose të ndryshojmë qendrat ekzistuese. Në varësi të qendres gjinden edhe lodrat, mjete materialet të cilat përkojnë me atë qendër. Kryesisht materialet vendosen në raft të hapura ku fëmijët mund të kenë mundësi për përdorimin e tyre. Disa nga qendrat e aktiviteteve tek metodologjia Rexhio Emilo janë:

Qendra e librit- vendoset në një kënd më të qetë ku krahas një rafti me rende ku vendosen librat dhe revistat e ndryshme gjendet një pjesë me shumë jastëk të butë ose kolltuk të vegjël ku fëmijët mund të shijojnë kënaqësinë që merr nga shfletimi dhe “leximi”. Fëmija në këtë kënd mund të hulumtojë mes librash për projektin e filluar, mund të mbaj shënime përmes vizatimit për të dhënat etj.

Qendra e matematikës- përmbanë materiale të organizuara të cilat mund të përdoren për klasifikimi, radhitje, numërim, etj. është e rëndësishme të përmendet se në metodologjinë Rexhio Emilia qendrat e aktiviteteve janë të ndërvarura njëra me tjetrën gjë e cila siguron që fëmijët të lëvizin lirshëm nga njëra qendër në tjetrën por edhe të zhvillojnë aktivitetin në mënyrë të veçantë nëse ata kanë nevojë për një gjë të tillë.

Qendra e lojës konstruktive- është hapësirë e cila është e konceptuar të ndryshojnë në vazhdimësi në varësi të projektit i cili realizohet, nëse në insitucion është duke u zhvilluar një projekt që lidhet me tregun atëherë fëmijët punojnë që bashku që kjo qendër të kthehet në një treg duke e regulluar atë sipas karakteristikave përkatëse, nëse kemi një projekt që flet për profesionet dhe fëmijët pëlqejnë zjarrëfikësit atëherë kjo qendër merr të tjera karakteristika, konstruktruktimi me blloqe të mëdha (si psh. kuti këpucësh të mbështjellura

nëvarësi të ngjyrës që na duhet) i'u mundëson fëmijëve të fitojnë eksperiencë të reja, balanci, pësha, lëvizja në këtë rast janë pjesë e eksperiencës së drejtpërdrejt të fëmijës.

Qendra e pasqyrës- është njëra ndër qendrat e cila i ndihmon fëmijët të zhvillojë aftësitë perceptivë duke filluar me njohjen e vetës, të tjerëve përreth por edhe ofrimin e mundësisë për të parë gjërat nga një perspektivë tjetër. Qendra zakonisht është e vendosur në njërin kënd të dhomës në mënyrë që të jenë të vendosura dy pasqyra përkrah njëra-tjetrës. Pasqyrat për nga lartësia e vendosjes fillojnë nga niveli i tokës deri afërsisht në lartësinë e fëmijëve.

Qendra e mesazheve- është një vend brenda dhomës ku secili fëmijë ka nga një kuti të personalizuar, ky vend shërben sikurse një postë e cila shpërndan mesazhe në mes fëmijëve dhe edukatorëve/eve sa herë që ata ndiejnë nevojën ta bëjnë një gjë të tillë. Kjo qendër i'u mundëson fëmijëve të shfrytëzojnë formën të tjera komunikimi përveç komunikimit verbal sa herë që ata ndiejnë nevojën për ta bërë një gjë të tillë. Në të njëjtën kohë kjo qendër shërben për edukatorin/en një pikë orientuese në procesin e observimit dhe dokumentimit të të dhënave. Shpeshherë nga komunikimet e tilla në mes të fëmijëve mund të lindin edhe projektet (Mato & Kamani, 2000).

Qendra e veshjeve- është qendra në të cilën janë të vendosura rrobe të ndryshme përfshirë veshje, këpucë, qanta, maska, kapele, syze, paruke e shumë gjëra të tjera të cilat janë të ndërlydhura me emitimin dhe luajtjen e roleve. Këto rrobe mund të përdoren tek kjo qendër ku fëmijët mund të luajnë lojëra me role ose të dramatizojnë ngjarje, tregime të ndryshme apo të përdoren edhe në hapësirat e përbashkëta të institucionit në varësi të aktivitetit që zhvillohet. Ky këndë pasurohet në mënyrë të vazhdueshme edhe nga famijet dhe shpesh herë mund të ndodhë që nga një dramatizim lind edhe nevoja për zhvillimin e ndonjë projekti i cili si pikënisje ka kureshtjen e fëmijëve për të eksploruar më tepër rreth një dukuri të caktuar.

Qendra e rërës dhe ujit, qendra e muzikës, qendra e lojës në tryezë janë poashtu qendra të cilat i gjejmë në mjediset e institucioneve të cilat punojnë me metodologjinë Rexhio Emilia.

Qendra e artit- përmban të gjitha materialet e nevojshme për zhvillimi e veprimtarisë artistike duke përfshirë jo vetëm vizatimin dhe ngjyrosjen por edhe formimin e modeleve, punës me materiale si plastelina, argjila, etj. Hapësira ofron një tavolinë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë si dhe disa këmbalec për vendosjen e vizatimeve dhe ngjyrosjen me bojëra të lëngshme. Fëmijët janë të lirë të punojnë në formë individuale, në dyshe ose në grupe të vogla.

Atelieja dhe miniatelietë- karakteristikë identifikuese e metodologjisë Rexhio Emilia është atelieja dhe miniatelietë, të cilat i japin fëmijës mundësi që përmes formave të ndryshme të shprehjes artistike të vë në zbatim respektimin e “100 gjuhëve të fëmijës”. Atelieja udhëhiqet nga artisti i artit figurativ i cili njih poashtu karakteristikat zhvillimore të fëmijës dhe filozofinë e edukimit sipas metodologjisë rexhiane. Këtu fëmijët punojnë me grupe të vogla, nën vëzhgimin e atelieistit/res i/e cili/a dokumenton komunikimin në mes të fëmijëve, aftësinë e zgjidhjes së problemit, etj. Përmes punës në atelie krijohet mundësia që të kuptojmë secilin fëmijë brenda grupit, si për nga mënyra sesi ai/ajo ballafaqohet me situatën e po ashtu edhe na vinë në pah çfarë duhet të bëjmë që ai/ajo të zhvillojë akoma më tej vetëvetën. Përderisa puna në atelie udhëhiqet nga artistit ajo në miniatelie udhëhiqet nga edukatori/ja, kjo hapësirë është një pjesë pak me e veçuar e dhomës e cila është e ndarë në mënyrë fizike në mënyrë që fëmijët të mund të punojnë të qetë. Shpeshherë prindërit marrin pjesë në aktivitetet që zhvillohen dhe japin kontributin e tyre praktikisht. Gjatë gjithë procesit puna dokumentohet dhe ky dokumentim jo vetëm që shërben për të regjistruar punën me fëmijë por shërben edhe për të analizuar dhe interpretuar punën e bërë në mënyrë që ajo gjithmonë të avancohet tutje.

Prindërit dhe komuniteti janë pjesëmarrës aktiv në zhvillimin e veprimtarive, sidomos gjatë projekteve të cilat kanë një shirrje më të gjatë kohore dhe kërkojnë angazhim për aftësitë e veçanta që mund të kenë prindër-familjar të caktuar.

Ju mund të kërkoni për më shumë të dhëna në burimet elektronike si:
<https://www.reggiochildren.it/identita/reggio-emilia-approach/?lang=en>
<https://education.gov.scot/improvement/learning-resources/The%20Reggio%20Emilia%20Approach%20to%20Early%20Years%20Education>

Puna me fëmijët sipas metodologjisë Hap pas Hapi

Metodologjia e punës sipas programit Hap pas Hapi e zhvilluar për fëmijët në fëmijëri të hershme mbështetet në aspektin teorik në konstruktivizëm dhe praktikën e përshtatshme zhvillimore. Meqë metodologjia Hap pas Hapi mbështetet në demokratizimin e procesit të edukimit dhe arsimit, kjo metodologji u përhap mjaft shpejtë në vendet në zhvillim dhe vendet pas konflikteve.

Ky program është hartuar për të përmbushur nevojat specifike të fëmijës dhe për të respektuar traditat e ndryshme kulturore. Qëllimi i kësaj metodologjie është që fëmijët:

- Të jenë aktiv në procesin e të nxënës, kështu fëmija në mënyrë të vazhdueshme merr informacion rreth botës nëpërmjet lojës.
- Të ecën nëpërmjet fazave të parashikuara zhvillimore
- Nëpërmjet bashkëveprimit shoqëror zhvillojnë vetveten
- Janë individ unik, të cilët rriten dhe zhvillohen me ritme të ndryshme (Szanton & Coughlin, 1997)

Individualizimi i lojës- aktiviteteve mundëson që fëmija të zhvillojë vetveten në bazë të ritmit të tij të zhvillimit, por krahas individualizimit edukatori/ja zhvillon lojëra dhe aktivitetet të cilat e ndihmojnë në planifikim e një game të gjerë të aktiviteteve të cilat organizohen në bashkëpunim me fëmijët në grupe të vogla edukative.

Roli i edukatorit/es sipas metodologjisë Hap pas Hapi

Janë edukatorët/et ata/ato të cilët i japin jetë secilës metodologji të edukimit parashkollor, përfshirë këtu edhe metodologjinë Hap pas Hapi. Në metodologjinë Hap pas Hapi edukatori/ja është përgjegjëse për të transformuar mjedisin ku fëmijët qëndrojnë për shkak të mirë funksionimit dhe përmirësimit të cilësisë së ndërveprimit me mjedisin apo edhe me personat e rritur përreth. Edukatori/ja ofron siguri për fëmijën, inkurajon dhe nxitë atë drejt lojës së pavarur duke i lehtësuar procesin e të nxënës përmes

Një formë e dobishme për krijimin e një projekti tematik është përdorimi i një modeli i cili bazohet në tre pyetje kryesore

- çfarë ndjejmë ne?
- çfarë duam të dimë?
- çfarë kemi mësuar?

krijimit të mjedisit për vetaktivitet të fëmijës. Sipas Jakman (2012) është përgjegjësi e edukatoreve që të ndihmojnë fëmijët që të zhvillojnë lojën e tyre, loja duhet të jetë pjesë integrale e të gjithë procesit edukativ që zhvillohet në institucionet parashkollore.

Edukatori/ja planifikon zhvillimin e aktiviteteve mbi bazë të temës javore ose mujore. Duke integruar kështu punën me tërë grupin, punë me grupe të vogla dhe punën individuale të fëmijës. Observimi është një tjetër karakteristikë e metodologjisë Hap pas Hapi ku edukatori/ja studion dhe analizon veprimet, sjelljet, fjalorin, etj të fëmijës për t'i ofruar ndihmën e nevojshme në varësi të nevojave që ai/ajo ka.

Rutina ditore mundëson fleksibilitet në shtrirjen e lojërave, aktiviteteve të cilat i zhvillon me fëmijët e tjerë të grupit edukativ nëpër qendrat e ndryshme të aktivitetit. Edukaret sipas Hap pas Hapi planifikojmë dhe mbështesin fëmijët drejt fitimit të shkathtësive për jetë.

Rregullimi i mjedisit sipas metodologjisë Hap pas Hapi

Përgatitja e mjedisit dhe organizimi i qendrave të aktiviteteve është përgjegjësi e edukatores andaj një kujdes i tej shtuar duhet ti kushtohet përcaktimit të qendrave të aktiviteteve me hapësirën e dhomës kur dihet se jo gjithmonë mund të kemi hapësirën që na nevojitet. Rregullimi i mjedisit duhet të jetë në harmoni dhe të ofrojë një mjedis të ngrohtë fizik dhe emocional në mënyrë që fëmijët të ndihen të pranuar dhe të gatshëm për lojë. Për zhvillimin e lojës- aktiviteteve përdoret hapësira e brendshme por edhe ajo e jashtme.

Rregullimi i mjedisit duhet të marrë parasysh kushtet fizike sikurse temperatura, lagështia, ndriçimi, nivelet e zhurmës të cilat janë parakusht që duhet respektuar nga të gjitha institucionet në mënyrë që ai institucion të funksionojë normalisht.

Të gjitha mjediset e të nxënit në metodologjinë Hap pas Hapi kanë tri karakteristika të përbashkëta: (a) eksperiencën e të nxënit individual, (b) vënien e theksit në të nxënit nëpërmjet lojës dhe përzgjedhjeve, (3) pjesëmarrjen e familjes (Szanton & Coughlin, 1997).

Për fëmijët nga mosha 6/9/muaj- 3 vjeç organizimi i hapësirës bëhet në përputhje me grupmoshën e fëmijës. Lodrat, lojërat dhe materialet didaktike janë të ekspozuara në qendra të hapura në të cilat fëmijët kanë qasje shumë të lehtë. Një mjedis i rregulluar mirë stimulon fëmijën për procesin e të nxënimit dhe inkurajon atë të provojë lojëra të reja të pa provuara më parë. Përdorimi dhe leximi i librave të ndryshëm ndihmon fëmijët në rritjen e aftësive vetëshprehese, poashtu lojërat të ndryshme që nxisin kujtesën e fëmijëve etj. lojërat-aktivitete zhvillohen në hapësirën e brendshme dhe atë të jashtme të institucionit dhe ka për qëllim zhvillimin e aktiviteteve që i ndihmojnë fëmijës të zhvillohet në të gjitha fushat zhvillimore.

Rregullimi i mjedisit për fëmijët nga mosha 3-5 vjeç bazuar në metodologjinë Hap pas Hapi siguron një mjedis ku fëmijët mund të veprojnë të lirë mbi zgjidhjet e tyre për lojë dhe aktivitete duke ruajtur edhe hapësirën e tjetrit. Dhoma është e ndarë nëpër qendra të aktiviteteve të cilat kanë ndërlidhje njëra me tjetrën. Gjatë sistemimit dhe vendosjes në dhomë duhet ti kushtohet kujdes organizimit të qendrave. Edukatori/ja përmes vëzhgimit mund të bëjë edhe ndryshime në mjedisin e të nxënimit nëse edukatori/ja ka konstatuar që një pjesë e hapësirës nuk është në shfrytëzimin e duhur dhe që aty mund të ridizenjohet për të organizuar një qendër tjetër. Qendrat e aktiviteteve përmbajnë shumëllojshmëri materiale të cilat fëmijët i përdorin në mënyrë kreative.

Ndër qendrat të cilat i gjejmë tek programet që punojnë me Hap pas Hapi janë:

Qendra e shkrim-leximit— ambienti për mësimin e gjuhës duhet të planifikohet me kujdes. Qendra ka një kënd librash , tavolinën e krijimit të librave, një kënd të rehatshëm i cili mund të shërbejë edhe si hapësirë për veprimtari të qeta,. Qendra duhet të jetë e pajisur me materiale të cilat nxisin dëshirën e fëmijës për të manipuluar me materiale të cilat kanë të bëjnë me shkronjat dhe zhvillimin e shkathtësive për shkrim.

Qendra e matematikës- përmes qendrës së matematikës fëmija zhvillon bazat e të nxënimit të matematikës të cilat përmes projekteve të përbashkëta zhvillohet edhe më tej. Aktivitetet me përbërje të së cilëve ka numra, numërim, krahasim, matje, gjeometri, vlerësim të gjitha i takojnë fushës së matematikës. Nuk duhet harruar se e gjithë kjo veprimtari në thelb ka fëmijën aktivisht të përfshirë në procesin e të nxënimit.